

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOSOVËS**  
**TË MBAJTUR MË 10.02.2006**

**SA SVEČANE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA**  
**ODRŽANE 10.02.2006. GODINE**

**Shkurt – Februar**  
**2006**

## **KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS, NEXHAT DACI:**

Ju dëshiroj mirëseardhje në seancën solemne të Parlamentit të Kosovës me të vetmen pikë të rendit të ditës, zgjedhjen e Kryetarit të ri të Kosovës.

Në sallë janë të pranishëm 102 deputetë, do të thotë se mund të punojmë me normalitet dhe kapacitet të duhur dhe të plotë.

E nderuara dhe e respektuara familje e Presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova,

Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare të Kosovës, i nderuari myftiu Tërnavë, të nderuar përfaqësues të Kishës Katolike,

Të nderuar përfaqësues të misionit ndërkombëtar në Kosovës dhe të zyrave diplomatike,

Të nderuar përfaqësues të shkencës, të dijes, të artit dhe të mbrojtjes e të sigurisë,

Të nderuar mysafirë, që me prezencën Tuaj i keni dhënë një karakter më solemn dhe më manifestiv kësaj mbledhjeje,

Mbledhja e sotme e Kuvendit të Kosovës do të dëshmojë si shumë herë të tjera, unitetin e popullit të Kosovës, unitetin e përfaqësuesve politik dhe institucional që të jenë si gjithëherë së bashku dhe në lartësinë e duhur të përgjegjësisë dhe të detyrave që dalin nga vota e popullit.

Deputetë të respektuar, ne sot do të zgjedhim Kryetarin e Kosovës, simbolin e unitetit të popullit dhe kështu, do të dëshmojmë punën dinjitoze institucionale në ndërtimin e strukturave shtetërore të Kosovës.

Vdekja e presidentit të parë të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, të liderit shpirtëror e historik të popullit të Kosovës, i cili me aq urti dhe mençuri diti të na udhëheqë tash e gjashtëmbëdhjetë vjet në rrugën tonë të sigurt drejt pavarësisë së vendit, është një humbje shumë e madhe për të gjithë ne, në këto momente vendimtare për fatin tonë. Kjo na obligon të gjithëve që të shkojmë përpara, që të ndërtojmë Kosovën - shtet të pavarur e sovran, shtet të anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe të integruar në strukturat veri-atlantike, në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Deputetë të nderuar, zgjedhja e Kryetarit të Kosovës sot dëshmon përkushtimin tonë serioz për punë institucionale, dëshmon besimin dhe vullnetin tonë që së bashku me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare të ndërtojmë një vend normal të sundimit të ligjit, të jetësisë së parimeve demokratike, ku të gjithë qytetarët, pa dallim, do të kishin liri dhe të drejta të barabarta dhe ku të gjithë ne do të aspironim një të ardhme të lumtur në Kosovën tonë, ku mund të jetojmë, të punojmë, të shkollohemi, të kemi një prosperitet e

zhvillimin ekonomik të lakmueshëm dhe ku fëmijët tanë dhe gjeneratat e ardhshme do të kenë të gjitha parakushtet për një jetë dinjitoze e të rehatshme, për të cilën me shekuj vepruan dhe u sakrifikuan djemtë dhe vajzat më të mira të popullit tonë, në përpjekjet e pareshtura për çlirim, që kulmuan me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës..

Të nderuar deputetë,

Jam i sigurt se zgjedhja e sotme e Kryetarit të Kosovës do të jetë një interes madhor i vënë mbi interesat partiake, do të jetë personaliteti unifikues në Kosovë, reprezentues i denjë i interesave më sublimë të popullit të Kosovës, i të gjithë qytetarëve të saj pa dallim.

Ju faleminderit!

Deputetë të nderuar, sot në rend dite të kësaj seance solemne kemi një përgjegjësi të veçantë në përmbushjen e obligimit kushtetues për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës, në pajtim me kreun 9, 2, 8 të Komizës Kushtetuese dhe rregullën 16 të Rregullores së Punës së Kuvendit, të drejtën për të nominuar kandidatin për kryetar të Kosovës e ka partia që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend ose me përkrahjen e së paku 25 deputetëve. Konform këtyre rregullave procedurale ju njoftoj se LDK si parti që ka siguruar numrin më të madh të vendeve me shkrim i është drejtuar Kryesisë dhe Kuvendit me propozim që dr. Fatmir Sejdiu anëtar i Kryesisë së Kuvendit, të zgjidhet Kryetar i Kosovës. Megjithatë, e ftoj nënkryetarin e LDK që edhe para jush në Parlament të deklarohet për vendimin e LDK. z. Berisha, foltorja është e Juaja.

#### **DEPUTETI KOLË BERISHA:**

I nderuari kryetar i Kuvendit, z. Daci, i nderuari kryeministër Kosumi dhe anëtarë të Qeverisë, të nderuar përfaqësues të Korit Diplomatik në Kosovë, të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë moment ku çdo gjë në këtë sallë, pra edhe dalja ime në këtë foltore duhet të shënojë një akt solemn dhe demonstrim të pjekurisë sonë politike, emocionet megjithatë oscillojnë në mes të dhembjes dhe të besimit. Them të dhembjes, sepse një vit më parë nga po kjo foltore në emër të LDK për president të Kosovës fare thjesht dhe fare shkurt solla para jush emrin e njeriut, i cili nga 21 janari i këtij viti fizikisht nuk është në mesin tonë. Atëbotë as mua, as ju kolegë të nderuar deputetë, nuk na shkonte mendja dhe nuk pyesnim se mandati i dytë i presidentit tashmë të ndjerë dr. Ibrahim Rugova, do të jetë kaq i shkurtër. Them të besimit, sepse njeriu i cili, duke pasur votën e këtij Kuvendi për president të Kosovës, në punën e tij prej pedagogu, punëtori të zellshëm të shkencës dhe intelektualit të mirëfilltë, me një kulturë të gjerë dhe njohës i mirë i rrethanave aktuale në vend dhe jashtë, me përvojën e tij të deritashme organizative dhe politike, me njeriun i cili reflekton tolerancë, bashkëpunim dhe mirëkuptim dhe duke qenë përherë njëri nga bashkëpunëtorët më të afërt të paraardhësit e tij, të presidentit tashmë të ndjerë dr. Ibrahim Rugovës, do ta arsyetojë besimin tonë. Prandaj, deputetë të nderuar, kam nderin

që në emër të LDK-së të sjellë para jush vendimin e Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, të datës 6 shkurt 2006, me të cilin për president të Kosovës në mandatin vijues propozohet prof. dr. Fatmir Sejdiu.

Fatmir Sejdiu është i lindur më 23 tetor 1951 në Pakashticë të Besianës, ish Podujevës, në Kosovë. Shkollën fillore dhe atë të mesme i ka kryer në Besianë, Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës më 1974, ku i mbaron edhe studimet pasuniversitare dhe merr titullin e doktorit të Shkencave Juridike. Si profesor ordinar është mësimdhënës i Fakultetit Juridik dhe në atë të Shkencave Politike të Universitetit të Prishtinës. Për studime të thelluara ka qëndruar në Francë, në Universitetin e Parisit II, dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Universitetin Shtetëror të Arizonës, si dhe ka realizuar qëndrime studimore edhe në universitete të tjera. Ka marrë pjesë në simpoziume dhe në konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare. Ka publikuar shumë punime shkencore nga fusha juridike, historike si dhe dy libra të veçantë nga këto dy fusha.

Fatmir Sejdiu është njeri ndër pjesëmarrësit e Kuvendit themelues të LDK të 23 dhjetorit të vitit 1989. Me 1991 në Kuvendin e parë zgjedhor zgjidhet anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të këtij subjekti. Më 1992 zgjidhet anëtar i Kryesisë, ndërkaq nga viti 1994 është edhe sekretar i përgjithshëm i LDK-së.

Z. Sejdiu është anëtar i Komisionit Qendror për organizimin e referendumit për pavarësinë e Kosovës të mbajtur në vitin 1991, si dhe njeri ndër personat kyç në përgatitjen, organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të Republikës së Kosovës të vitit 1992 dhe të vitit 1998. Në të dy këto zgjedhje, z. Sejdiu ishte deputet, madje në këto të vitit 1998 ishte edhe sekretar i përgjithshëm i Kuvendit dhe kryetar i Komisionit për Çështje Kushtetuese. Pas luftës së fundit, prof. Sejdiu në zgjedhjet nacionale demokratike të vitit 2001 zgjidhet deputet i Kuvendit të Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së tij. Në të njëjtin post zgjidhet edhe në legjislacionin e dytë. Prof. Sejdiu është njëri ndër hartuesit e aktit të parë më të lartë juridik të Kosovës së pasluftës, të Kornizës Kushtetuese, e cila edhe sot është në fuqi. Aktualisht është edhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Evropian. Ai komunikon anglisht, frëngjisht dhe serbokroatisht. Është i martuar dhe ka tre fëmijë. Jeton në Prishtinë. Prandaj, lus kryetarin e Kuvendit, z. Daci që propozimin e LDK-së ta vë në votim, ndërkaq nga ju kolegë të nderuar deputetë, kërkoj që me votën tuaj unanime për z. Sejdiu ta plotësojmë këtë vakum disaditësh institucional, pra ta bëjmë Kosovën sërish me president, duke qenë i bindur se ai me këmbëngulësi do të vazhdojë punën bashkë me institucionet e tjera, të gjitha forcat politike të vendit dhe me miqtë tanë ndërkombëtarë për realizimin e plotë të Pavarësisë së Kosovës.

Ju faleminderit!

#### **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:**

Z. Berisha, ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur kryetari i partisë që ka 30 ulëse në Parlament, z. Hashim Thaqi.

## HASHIM THAQI

I nderuari z. Kryetar, i nderuari z. Kryeministër, të nderuar zotëri deputetë, të nderuar mysafirë,

Fillimisht dua të shprehë falënderimin tim më të sinqertë duke kuptuar interesimin dhe shqetësimin tuaj për mungesën time. Unë e kam përjetuar përjetimin tuaj, i kam lexuar dhe kuptuar ndjenjat e disave për domosdoshmërinë e prezencës sime sot në këtë akt madhor, prandaj ju falënderoj. Gjithashtu, falënderoj për merakun e disave që kanë treguar për vështirësitë që kam pasur për tu kthyer nga vizita që kam pasur. Por, ju e dini se edhe gjatë kohës të këtyre peripecive e vështirësive që erdhën nga kushtet meteorologjike, më ka shkuar mendja tek karroca apo vështirësitë që i ka pasur me karrocën e nëntorit të madh Ismajl Qemajl Beu, kështu që prisja ndonjë vendim të madh të nëntorit të madh! Sido që të jetë, faleminderit dhe më vjen mirë shumë që ju gjeta ashtu si ju kam lënë!

Shpresoj dhe besoj se edhe zhgënjimi dhe dëshpërimi që janë paraqitur këto ditë për mungesën time, do të kalojnë dhe prezenca ime dhe energjia ime pozitive e konceptit dhe e partisë sime do të ndikojnë në kthimin e disponimit dhe të kënaqësisë, por edhe të suksesit.

I nderuari z. Kryetar, të nderuar deputetë,

Akti politik i zgjedhjes së organeve institucionale të shtetit të Kosovës në këto momente të veçanta është akt sublim që duhet të ketë parasysh përgjegjësinë politike ndaj vendit dhe qytetarëve të tij. Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se vonesat në përmbushjen e vakumit institucional në vend për muaj të tërë për ministrinë e reja, në krijimin dhe zvarritjet aktuale për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit shkojnë në adresë të formacioneve para politike dhe improvizimeve që shpeshherë po e përcaktojnë edhe agjendën e institucioneve aktuale të Kosovës.

Këto vonesa tani për një kohë të gjatë po e bëjnë peng të ardhmen e Kosovës dhe janë duke dëmtuar procesin politik në këto momente vendimtare. Partia Demokratike e Kosovës ka qasje në konceptin e vet të veprimit politik në shërbim të interesave të vendit dhe të gjithë qytetarëve të vet. Të nderuar kuvendarë, pushteti dhe shteti janë dimensione të ndara politike. Beteja për pushtet sot nuk duhet ta dëmtojë dhe vonojë ndërtimin e shtetit të Kosovës. Shteti ndërtohet me parime dhe koncepte të qarta, e jo me situata imagjinare. Sot është koha e unitetit, e bashkëpunimit dhe e tolerancës në ndërtimin e shtetit sovran të Kosovës. Uniteti ndërtohet duke biseduar e dialogu sjell mirëkuptim, respekt të ndërsjellë dhe sukses, e unë besoj dhe jam i bindur se viti 2006 do të jetë viti i vendimit, viti i suksesit, viti i pavarësisë së Kosovës, viti i zbatimit dhe i respektimit të vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Pra, jo dosido pavarësi, por shtet i pavarur dhe sovran me ulëse në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

PDK vlerëson se bashkëpunimi dhe komunikimi i brendshëm politik i hap rrugët edhe komunikimit dinjitoz të Kosovës si identitet i pavarur politik dhe juridik në bashkësinë ndërkombëtare. Në qeverisjen e vendit duhet të ndodhin sa më parë ndryshime kualitative. Kjo është në interesin e institucioneve dhe të të gjithë qytetarëve, por edhe në interesin dhe në përgjegjësitë tona në komunikim dhe bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare. Prandaj, është koha e fundit e riinstalimit të mendimit dhe të veprimit politik modern dhe qytetarë për qeverisjen e vendit dhe të evitohen skemat e kushtëzimeve para politike në qeverisjen aktuale të Kosovës. Plotësimi i standardeve demokratike të vëna si parakushte nga bashkësia ndërkombëtare, ndërtimi i klimës së mirëbesimit politik dhe përmirësimi i mirëqenies qytetare duhet të zënë vend primar në qeverisjen e vendit, që sot është peng i shantazheve dhe i presioneve para politike.

PDK si formacion më legjitim dhe i respektuar politik kosovar e bënë të qartë se pavarësisht nga ofertat para politike për krijimin e situatave improvizuese apo të bashkëqeverisjeve artificiale dhe të situatave improvizuese, si është kjo sot, do të ruajë pozicionin e vet politik aktiv konstruktiv dhe të përgjegjshëm opozitar. Do të vazhdojmë përkushtimin për të punuar dhe krijuar parakushte optimale të një kurorëzimi të suksesshëm të vullnetit politik të qytetarëve tanë për shtet sovran dhe demokraci qytetare, ku respektimi i vlerave humane të shoqërisë sonë të brendshme do të bëhet pavarësisht nga përkatësitë etnike, religjioze apo regjionale.

Të nderuar deputetë, zgjedhja e presidentit të vendit si institucion shtetëror duhet t'i shërbejë qëllimit tonë politik për ruajtje të unitetit nacional dhe komunikimit të brendshëm. Falënderoj edhe me këtë rast në mënyrë të veçantë popullin e Kosovës për qëndrimin dinjitoz dhe qytetarë që po tregojnë gjatë këtyre muajve historik për të ardhmen e vendit për shtetin sovran dhe të integruar në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO. I inkurajoj qytetarët për një vazhdimësi të tillë, uniteti dhe mirëkuptimi të brendshëm institucional dhe gjithë qytetarë, për një uniteti të brendshëm edhe tradicional.

PDK është e gatshme të punojë me të gjitha forcat politike që punojnë të ndërtojnë shtetin real të Kosovës dhe jo vetëm me simbolika. PDK edhe sot mendon dhe vepron pozitivisht, merr pjesë në votim dhe fton të gjithë spektrin politik të pozitës dhe opozitës, partitë e mëdha apo të vogla qofshin ato për solidarizim dhe reflektim në vendimin e drejtë të partisë demokratike të Kosovës që buron drejtpërdrejt nga vullneti i gjithë qytetarëve të Kosovës.

Veprimet dhe vendimet e mia politike dhe konceptin politik që përfaqësoj gjithmonë i ka përcaktuar dhe do t'i përcaktojë vullneti i qytetarëve të Kosovës dhe jo situata improvizuese. Partia Demokratike e Kosovës me identitetin e vet të qartë opozitar është duke treguar përgjegjësinë e duhur për momentin që po e kalojmë në konsolidimin e institucioneve demokratike të Kosovës. Prandaj, të nderuar deputetë, ky votim duhet të shërbejë për institucionin dhe jo individin, për unitetin dhe jo improvizimin, jo vetëm për zgjedhje të kryetarit, por për institucionin funksional në mënyrë që të përshpejtojë zgjedhjen e statusit politik, pra zbatimin e vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran. Prandaj, ju ftoj edhe njëherë për solidarizim me vendimin e PDK për votim. Ju faleminderit!

## **KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:**

Z. Thaçi, ju faleminderit! Unë ju bëjë thirrje për votim unik në parlament për një kandidat i cili ka marrë përkrahjen e të gjitha grupeve të tjera parlamentare. Vazhdojmë me procedurën e paraparë. Njoftojmë deputetët se zgjedhja e kryetarit të Kosovës do të bëhet me votim të qetë. Nëse në dy votimet e para kërkohet shumica e dy të tretave të votave të deputetëve të Kuvendit, që do të thotë 80 vota, në rrethin e tretë kërkohet shumica e votave të deputetëve të Kuvendit, pra 61 votë.

Unë jam i bindur që me unitetin e demonstruar në këtë periudhë të vështirë, këtë unitet do ta tregojmë edhe në këtë kuti të votimi dhe jam shumë i bindur që në raundin e parë, siç e kemi thanë vazhdimisht, do ta kemi kryetarin e ri të Kosovës dr. Fatmir Sejdiun. Megjithatë, me qëllim të respektimit të procedurave për votim të fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës, sekretaria e Kuvendit i ka bërë përgatitjet administrative dhe teknike duke siguruar: Komisionin votues prej 3 zyrtarëve të Departamentit Ligjor në përbërje: Defrim Krasniqi, Sali Rexhepi dhe Xheladin Hoxha, regjistrin e deputetëve, fletëvotimet, kutinë e votimet dhe dy vendvotime.

Ndërsa grupet parlamentare është e preferueshme të caktojnë nga një deputetë për të vëzhguar ose monitoruar procesin e votimit dhe të numërimit, prandaj ju lus deputetë që ngadalë, sipas ftesës në bazë të regjistrin, të marrim fletëvotimet dhe t'i kryejmë obligimet tona procedurale.

Unë i ftoj grupet parlamentare që secili prej tyre të caktojë anëtarin e vet që do të jetë pjesë e Komisionit.

Unë i lus gazetarët që të krijojnë atmosferë të votimit të fshehtë. Tash pason faza teknike dhe Parlamenti duhet të jetë i lirë.

Atëherë, fillojmë me procesin, që të mos humbim kohë. Afrim Arzullxhiu dhe Agim Krasniqi, le të përgatitet Alush Gashi dhe Bajram Kosumi. Gjithsej janë 103 deputetë. Bajram Rexhepi dhe Bajrush Xhemajli. Në sallë tani janë 110 deputetë të pranishëm, ju lutem. Behxhet Brajshori dhe Berat Luzha, Besa Gaxheri dhe Bislim Hoti, Brikenda Kryeziu dhe Bujar Dugolli, Demir Lima dhe Drita Statovci, Xhezair Murati dhe Emin Krasniqi, Emrush Xhemajli dhe Enver Hoxhaj. Më lejoni që sipas kërkesës procedurale ta ftoj Dragisha Kërstoviqin meqë është në regjistër të deputetëve. Dragisha Krstoviq mungon, nuk është në sallë, dhe Ethem Çeku, Fadil Geci dhe Fadil Kryeziu, Fatmir Rexhepi dhe Fatmir Sejdiu, Fatmire Mulhaxha – Kollqaku dhe Fehmi Mujota, Fehmi Vula dhe Ferid Agani, Fetah Berisha dhe Flora Brovina, Gani Koci dhe Gazmend Muhaxheri, Genc Gorani dhe Gojko Saviq, që mungon, Goran Bogdanoviq, mungon Gjergj Dedaj, Gjylshen Berisha dhe Gjylnaze Syla, Hajredin Hyseni dhe Hajredin Kuqi, Hashim Thaçi dhe Hatixhe Hoxha, Husnija Beshkoviq dhe Hydajet Hyseni, Ibush Jonuzi dhe Ilaz Pireva, Ilmi Ahmeti dhe Jakup Krasniqi, Januz Kastrati dhe Jusuf Sutaj, Kamber Kamberi dhe Kolë Berisha, Lulzim Zeneli dhe Lumnije Hyseni, Lutfi Zharku dhe Mahir Jakcilar, Mark Krasniqi dhe Mazllum Kumnova, Melihate Tërmkollli dhe Milazim Haliti,

Myrvete Dreshaj – Baliu dhe Nafije Berisha, Naim Jerliu dhe Naim Maloku, Nait Hasani dhe Naser Osmani, Naxhije Doçi dhe Nazim Jashari, Nekibe Kelmendi dhe Nerxhivane Dauti, Nexhat Daci dhe Nexhat Rexha, Nimon Alimusaj dhe Numan Baliq, Nuran Malta dhe Nurishahe Hulaj, Oliver Ivanoviq, mungon, Qibrije Hoxha dhe Ragip Zekolli, Ramadan Kelmendi dhe Ramadan Musliu, Ramë Buja dhe Rangjell Nojkiq, mungon, vjen Remzije Nimani, Rifat Krasniq dhe Rudina Bukoshi, Rrustem Ibishi dhe Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti dhe Sadudin Berisha, Sala Ahmetaj dhe Safete Hadërgjonaj, Sala Shala dhe Sanije Zeqiraj, Sanije Alijaj dhe Sasha Gjokiq, Selvije Halimi dhe Sllagjan Iliq, mungon, Snezhana Miliq, mungon, Sokol Bashota, Shaban Halimi dhe Shpresa Murati, Teuta Hadri dhe Teuta Sahatqija, Teuta Hadri mungon, Vesna Jovanoviq gjithashtu mungon, Veton Surroi dhe Xhavit Haliti, Xhelal Canziba dhe Xhevat Bislimi, Xhevdet Neziraj dhe Ylber Hysa, Imer Halimi dhe Imer Muhaxheri, Zahrije Jusufi dhe Zef Morina, Zllatica Kujunxhiq dhe Zyhrije Maloku, dhe të fundit Zylfi Merxha dhe Zylfije Hundozi.

Tani ftoj tre anëtarët e caktuar të grupeve parlamentare që t'i numërojnë dhe të kontrollojnë numrin e votave. Ne do të presim në sallë, sepse është procesi i shpejtë.

Lus të gjithë deputetët që të jenë në vendin e vet. Raport mbi rezultatet e votimit për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës. Në votim kanë marrë pjesë të gjithë deputetët. Të pranishëm janë 110 deputetë,

Për kanë votuar .....78 deputetë,  
 Kundër kanë votuar .....8 deputetë  
 Të pavlefshme janë .....24 fletëvotime,

---

Gjithsej 110 deputetë të pranishëm

Kjo do të thotë që duhet të shkojmë në raundin e dytë të votimit. Le të përgatitet shërbimi, ju lutem, le të vazhdojmë menjëherë me raundin e dytë.

Ju lutem, nuk ka pauzë deri në përfundim. Pa i dalë tymi oxhakut, nuk ka lëvizje për deputetë. Deputetët e parlamentit në ulëset e veta në kohën ma të shpejtë, ju lutem!

Ju lutem, fillojmë raundin e dytë të votimit. Afrim Arzullaxhiu dhe Agim Krasniqi, Alush Gashi, Bajram Kosumi, Bajram Rexhepi, Bajrush Xhemali, Behxhet Brajshori, Berat Luzha, Besa Gaxheri, Bislim Hoti, Brikenda Kryeziu, Bujar Dugolli, Demir Lima Dragisha Kërstoviq, nuk është, Drita Statovci.

Edhe një herë regjia le t'i ftojë deputetët në sallë, Xhezair Murati, nuk po e shoh që është në sallë, arriti edhe Emrush Xhemali, Emin Krasniqi, Xhezairin jemi duke e pritur, Enver Hoxhaj, Ethem Çeku, Xhezairi e mori fletëvotimin, do të thotë është këtu, Fadil Gashi dhe Fadil Geci, Fadil Kryeziu, Fatmir Rexhepi, Fatmir Sejdiu, Fatmire Mulhaxha Kollçaku, Fehmi Mujota, Fehmi Vula, Ferid Agani, Fetah Berisha, Flora Brovina, Gani Koci, Gazmend Muhaxheri, Genc Gorani, a është në sallë, Genc Gorani le të kthehet kur

të mundet, Gojko Saviq, nuk është, Goran Bogdanoviq, nuk është Gjergj Dedaj, Genc Gorani, Gjylshen Berisha, Gjylnaze Syla, Hajredin Hyseni, Hajredin Kuqi, Hashim Thaqi, Hatixhe Hoxha, Hysnija Beshkoviq, Hydajet Hyseni, Ibush Jonuzi, Ilaz Pireva, Ilmi Ahmeti, Jakup Krasniqi, Jonuz Kastrati, Jusuf Sutaj, Kamber Kamberi, Kolë Berisha, Lulzim Zeneli, Lumnije Hyseni, Lutfi Zharku, Mahir Yagcilar, Mark Krasniqi, Mazllum Kumnova, Melihate Tërmkolli, Milazim Haliti, Myrvete Dreshaj Veliu, Nafije Berisha, Naim Jerliu, Naim Maloku, Nait Hasani, Naser Osmani, Naxhije Doçi, Nazim Jashari, Nexhat Daci, Nexhat Rexha, Niman Alimusaj, Numan Baliq, Nuran Malta, Nurisha Hulaj, Oliver Ivanoviq, mungon, Qibrije Hoxha, Ragip Zekolli, Ramadan Kelmendi, Ramadan Musliu, Ramë Buja, Rangjel Nojkiq, mungon, Remzije Nimani, Rifat Krasniq, Rudina Bukoshi, Rustem Ibishi, Sabit Rahmani, Rustem Ibishi a e mori fletëvotimin, mungon, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Sadudin Berisha, Safete Hadergjonaj, Sala Ahmetaj, Sala Shala, Sanije Zeqiraj, Sanije Alijaj, Sasha Gjokiq, Selvije Halimi, Sladjan Iliq, mungon, Snezhana Iliq, mungon, Sokol Bashota, Shaban Halimi, Shpresa Murati, Teuta Hadri, mungon, Shpresa Murati dhe Teuta Sahatqija, Vesna Jovanoviq, mungon, Veton Surroi dhe Xhavit Haliti, Xhelal Canziba dhe Xhevat Bislimi, Xhevdet Neziraj dhe Ylber Hysa, Ymer Halimi, Ymer Muhaxheri, Zahrije Jusufi, Zef Morina, Zatica Kujunxhiq, Zyhrije Maloku, Zylfi Merxha dhe Zylfije Hundozi.

Mbasi ka votuar edhe kandidati i fundit, ju lutem numëroni votat dhe mbikëqyrni numërimin e votave!

Më lejoni t'ju komunikoj rezultatin e votimit të dytë për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. Në votim kanë marrë pjesë 110 deputetë:

Për kanë votuar .....77 deputetë,  
 Kundër kanë votuar .....9 deputetë  
 Të pavlefshme janë .....24 fletëvotime

---

Gjithsej: 110 deputetë

Vazhdojmë menjëherë me raundin e tretë. Teknika besoj se është gati, ju lutem që të mos e lëshoni sallën dhe të mos humbim kohë.

Afrim Arzullaxhiu dhe Agim Krasniqi, Alush Gashi dhe Bajram Kosumi, Bajram Rexhepi, Bajrush Xhemaili, Behxhet Brajshori, Berat Luzha, le të kthehet në sallë, merreni fletën Berat, Bislim Hoti, Brikenda Kryeziu, Bujar Dugolli, Demir Lima, Besa Gaxherri, Dragisha Kërstoviq, mungon, Drita Statovci, Xhezair Murati, Emin Krasniqi, Emrush Xhemajli dhe Enver Hoxhaj, Ethem Çeku, Fadil Gashi, Fadil Geci dhe Fadil Kryeziu, Fatmir Rexhepi, Fatmir Sejdiu, Fatmire Mulhaxha- Kollqaku, Fehmi Mujota, Fehmi Vula, Ferid Agani, Fetah Berisha, në qoftëse nuk është në sallë, le të kthehet! Flora Brovina, Gani Koci, Gazmend Muhaxheri, Genc Gorani, Gojko Saviq, nuk është, Goran Bogdanoviq, nuk është, Gjergj Dedaj, Gjylshen Berisha, Fetah Berisha, e merrni fletëvotimin, ju lutem, Gjylnaze Syla, Hajredin Hyseni, Hajredin Kuqi, Hashim Thaqi, Hatixhe Hoxha, Hysnija Beshkoviq, Hydajet Hyseni, Ibush Jonuzi, Ilaz Pireva, Ilmi Ahmeti, Jakup Krasniqi, Jonuz Kastrati, Jusuf Sutaj, Kamber Kamberi, Kolë Berisha, Lulzim Zeneli, Lumnije Hyseni, Lutfi Zharku, Mahir Yagcilar, Mark Krasniqi, Mazllum Kumnova, Melihate Tërmkolli, Milazim Haliti, Myrvete Dreshaj, Nafije Berisha, Naim

Jerliu, Naim Maloku, Nait Hasani, Naser Osmani, Naxhije Doçi, Nazim Jashari, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Nexhat Daci, Nexhat Rexha, Niman Alimusaj, Numan Baliq, Nuran Malta, Nurisha Hulaj, Oliver Ivanoviq dhe Qibrije Hoxha, mungojnë, Ragip Zekolli, Ramadan Kelmendi, Ramadan Musliu, Ramë Buja, Rangjel Nojkiq, mungon, Remzije Nimani, Rifat Krasniq, Rudina Bukoshi, Rustem Ibishi, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Rustem Ibishi, Sadudin Berisha, Safete Hadergjonaj, Sala Ahmetaj, Sala Shala, Sanije Zeqiraj, Sanije Alijaj, Sasha Gjokiq, Selvije Halimi, Slagjan Iliq mungon, Snezhana Miliq, mungon, Sokol Bashota, Shaban Halimi, Shpresa Murati, mungon dhe Teuta Sahatqija, Vesna Jovanoviq, mungon, Veton Surroi dhe Xhavit Haliti, Xhelal Canziba, mungon, Xhevat Bislimi, dhe Xhevdet Neziraj, Xhevati mungon, nuk është këtu, Xhevat Bislimi le të kthehet në sallë, Xhevdet Neziraj dhe Ylber Hysa, Xhevat Bislimi e merrni fletëvotimin, ju lutem, Ymer Halimi Ymer Muhaxheri, Ymer Halimi, Zahrije Jusufi, Zef Morina, Zatica Kujunxhiq, Zyhrije Maloku, Zylfi Mergja dhe Zylfije Hundozi .

Meqë votimi ka përfunduar, lus Komisionin për numërimin e votave dhe ata që mbikëqyrin procesin e votimit që të fillojnë punën e vet.

Për kanë votuar .....	80 deputetë,
Kundër kanë votuar .....	12 deputetë
Të pavlefshme janë .....	17 fletëvotime
<hr/>	
Gjithsej:	109 deputetë

Unë mendoj që mund t'ju raportoj rezultatin e votimit. Në votim kanë marrë pjesë 109 deputetë, për kanë votuar 80, kundër 12, të pavlefshme janë 17 vota. Prandaj, konstatoj se me dy të tretat e votave në raundin e tretë e kemi zgjedhur kryetarin e Kosovës dr. Fatmir Sejdiun. Më lejoni që në emër të të gjithë deputetëve ta lus presidentin e ri që ta jap fjalën e vet përshëndetëse, dhe ju ftoj në emër të kryetarit të parlamentit në një kafe, duke përfshirë edhe të gjithë mysafirët, por faturën kësaj radhe ia dërgojmë presidentit të ri.

## **KRYETARI I KOSOVËS FATMIR SEJDIU**

*Të nderuar deputetë,*

*I nderuari Kryetar i Kuvendit z.Daci,*

*I nderuar Kryeministër Kosumi dhe anëtarë të Qeverisë,*

*I nderuar PSSP Soren Jesen Petersen,*

*Të nderuar përfaqësues të Korit Diplomatik në Kosovë,*

*Të nderuar përfaqësues të Bashkësisë Islame dhe të Ipeshkëvisë së Kosovës, të Akademisë së Shkencave dhe mysafirë të tjerë,*

*E nderuar familje e Presidentit Rugova,*

*Të dashur qytetarë të Kosovës,*

Ju, përfaqësues të popullit në Kuvendin e Kosovës, më keni nderuar sot duke më zgjedhur President të vendit tonë - Kosovës. Ky është nderim dhe privilegj i madh për

mua, por njëkohësisht barrë me peshë dhe përgjegjësi të veçantë. Unë zgjidhem në këtë detyrë dhe marr postin që ka mbajtur Presidenti ynë i parë dhe tashmë historik, dr. Ibrahim Rugova. Këtë post të lartë Presidenti Rugova e bënte edhe më të madh me figurën e vet të veçantë prej njeriu e prijësi të papërsëritshëm.

Presidenti Rugova ka lënë një trashëgimi të pasur politike e shtetërore, të ndërtuar me dije, me mund e sakrifica, por edhe me guxim të pashoq, për më shumë se një dekadë e gjysmë. Kjo trashëgimi ka shtruar rrugën e sigurt për të përmbyllur procesin e pavarësimit të vendit tonë të dashur, Kosovës. Pavarësia nuk është vetëm një privilegj për të jetuar të lirë e me dinjitet njerëzor e nacional, por është edhe obligim dhe përgjegjësi, gjithashtu.

*Të nderuar deputetë,  
Të dashur qytetarë të Kosovës,  
Zonja dhe zotërinj,*

Presidenca e Kosovës, nën udhëheqjen time, do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e tjera të Kosovës, me partitë politike në pushtet dhe në opozitë, me grupet etnike dhe të gjithë qytetarët e Kosovës për të siguruar unitetin e popullit dhe funksionimin demokratik të institucioneve të vendit, si dhe përshpejtimin e proceseve për zhvillimin ekonomik, prosperitetin e përgjithshëm dhe mirëqenien e plotë të të gjithë qytetarëve. Kjo është detyrë e imja kushtetuese, ky është obligim qytetar imi dhe i secilit institucion e qytetar të vendit, siç domos tani që përmbushja e synimit tonë për Kosovën shtet të pavarur e sovran është afër.

Si President, do të vazhdoj bashkëpunimin e ngushtë me UNMIK-un dhe KFOR-in, TMK-në dhe SHPK-në, për të forcuar më tej institucionet e Kosovës dhe sigurinë e vendit.

Fillimi tashmë i një procesi të gjithanshëm ndërkombëtar për përcaktimin e statusit të Kosovës shtron para nesh detyra esenciale.

Ju siguroj se unë, si President, do të kem angazhim parësor udhëheqjen dhe vazhdimin e punës së Ekipit Negociator të Kosovës si ekip i unitetit, ashtu si e kishte strukturuar Presidenti Ibrahim Rugova, për të përshpejtuar këtë proces përballë nevojave të vendit tonë dhe vendosmërisë së bashkësisë ndërkombëtare për ta përmbyllur me sukses këtë proces sa më parë, gjatë këtij viti, në përputhje të plotë me vullnetin e popullit të Kosovës. Në këtë kuadër, bashkëpunimi i ngushtë me Emisarin e OKB-së për Statusin e Kosovës, Presidentin Maarti Ahtisaari, ka rëndësi të veçantë.

Po ashtu, zotohem se unë dhe ekipi im do të bashkëpunojmë ngushtë me SHBA-të, Unionin Evropian dhe Grupin e Kontaktit, me qëllim që Kosovën ta bëjmë shtet në paqe me veten dhe fqinjët e vet, një vend që do të garantojë të gjitha liritë qytetare, njerëzore dhe të pakicave, në pajtim me standardet më të larta që ka vendosur bota demokratike. Dhe në të njëjtën kohë të shprehim derjësinë tonë për të qenë partner i integruar në strukturat euro-atlantike.

Nga ky vend, nga Kuvendi i Kosovës, që është institucioni më i lartë që mbledh përfaqësuesit e të gjithë qytetarëve të Kosovës, të të gjitha përkatësive etnike, u bëj thirrje të gjithë qytetarëve, në veçanti pjesëtarëve të komunitetit serb, të punojmë së bashku për një Kosovë demokratike, prosperuese dhe tolerante, ku respektohen dhe nderohen veçantitë e secilit.

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës,

Betohem solemnisht se do të ruaj dhe mbroj unitetin e popullit, tërësinë tokësore të vendit, dhe do të siguroj funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës.

**KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI:**

Me kaq ka përfunduar seanca solemne me rastin e zgjedhjes së Kryetarit të Kosovës.